



Datë: 08.01.2026

Numër Protokolli: 54/2026

A.nr.1940/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1940/2025, të datës 25.11.2025, të parashtruar nga ankuesja E.N, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.01.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1940/2025, e datës 25.11.2025, e parashtruar nga ankuesja E.N.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, E.N (*në tekstin e mëtejme referuar: ankuesja*), sipas Konkursit me numër Reference RN00018579, të shpallur me datë 29.09.2025 nga Ministria e Punëve të Brendshme, për pozitën e punës Asistent Administrativ, në Qendrën për Pajisje me Dokumente në Prishtinë/ Agjencia e Regjistrimit Civil, me datë 25.11.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 12.11.2025, lidhur me refuzimin e aplikacionit të punësimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.12.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa kjo e fundit me datë 19.12.2025, ka dorëzuar përgjigjen me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave *(në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit)* nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Punëve të Brendshme, me datë 29.09.2025, ka publikuar Njoftimin për shpalljen e Konkursit me numër reference RN00018579, për pozitën e punës Asistent Administrativ, në Qendrën për Pajisje me Dokumente në Prishtinë/ Agjencia e Regjistrimit Civil, me afat aplikimi nga data 30.09.2025 deri më datë 29.10.2025.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rrjedhë se në konkursin përkatës ka aplikuar edhe ankuesja, mirëpo sipas Njoftimit të datës 12.11.2025, të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, rezulton se të njëjtës i është refuzuar aplikacioni i punësimit, me arsyetimin se nuk posedon dëshminë e diplomës së shkollës së mesme të kryer sipas kritereve të konkursit.

Ankuesja, kundër njoftimit të lartë cekur të datës 12.11.2025, ka parashtruar ankesë në Këshill, duke theksuar se: në konkurs nuk është kërkuar diploma e kualifikimit si dokument i domosdoshëm; gjatë aplikimit ka bashkangjitur diplomën Bachelor, e cila përfaqëson nivel më të lartë arsimor se diploma e shkollës së mesme dhe që dëshmon qartë kualifikimin e saj; refuzimi është bërë për shkak të një interpretimi teknik të dokumentit, dhe jo për mungesë të kualifikimit real nga ana e saj, si dhe duke qenë se niveli më i lartë arsimor përfshinë edhe nivelin bazë, e njëjta konsideron se ka përmbushur kriteret e konkursit, andaj kërkon rishqyrtimin e aplikacionit dhe korrigjimin e vendimit.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 39 paragrafi 12 ku përcaktohet se: *12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankesë në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative.* si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *17. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankesë në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve.*

Referuar këtij përcaktimi ligjor si dhe duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesja, më datë 25.11.2025, është e parakohshme, ngase, kandidati për pranim në shërbim civil ka të drejtë të parashtoj ankesë vetëm pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, ndërsa, në rastin konkret ankuesja ka parashtruar ankesë ndaj njoftimit të datës 12.11.2025 për refuzim të aplikacionit, si veprim procedural në fazën e verifikimit paraprak, rrjedhimisht pa u publikuar ende rezultatet përfundimtare të Konkursit me numër reference RN00018579, për pozitën e punës Asistent Administrativ, në Qendrën për Pajisje me Dokumente në Prishtinë/ Agjencia e Regjistrimit Civil.

Andaj, duke qenë se ankesa është parashtruar ende pa u shpallur njoftimi për rezultatin përfundimtar për procedurën përkatëse të rekrutimit, atëherë, në kuptim të dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4

të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e njëjta është e papranueshme, kështu që, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi të hedhë poshtë si të parakohshme ankesën A.nr.1940/2025, të datës 25.11.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë e ankesës si parakohshme, nuk mohon të drejtën e ankueses, që të kundërshtoj vendimin për refuzimin e aplikacionit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1940/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses E.N;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.